

VENDIM
Nr. 179, datë 20.8.2018

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 97, DATË 23.4.2018, “MBI MIRATIMIN E
TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAZ”
SHA, PËR VITIN 2018”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit, 13, pika 2 dhe nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 3, germa “g” dhe nenit 24, pika 4, të “Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi një shtesë në vendimin nr. 97, datë 23.4.2018, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018”, të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 797, datë 20.7.2018, Shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shpjegime referuar vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për vitin 2018”.

- Albgaz kërkon interpretimin e pikës 1 të vendimit të sipërcituar, në lidhje me afatin kur duhet të fillojë aplikimi i tarifës së re, për lëshimin e faturave tatimore sipas pikës 1 të këtij vendimi, referuar përcaktimeve në vendimin nr. 14, të Bordit të ERE-s, datë 10.1.2018, “Mbi shtyrjen e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 90, datë 7.6.2017, si dhe kontratës së transmetimit të gazit natyror të lidhur mes “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.”.

- Tarifa e përkohshme e transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., e miratuar për vitin 2017 dhe lënë në fuqi deri më 31.3.2018 nëpërmjet vendimit nr. 14, datë 10.1.2018, të Bordit të ERE-s përcakton një tarifë prej 25 lekë/m³.

- Tarifa e transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018 e miratuar me vendimin nr. 97, datë 23.4.2018, përcakton një tarifë prej 28 lekë/m³.

- Neni 17, germa “e”, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, parashikon që kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese.

- Mes tarifës së përkohshme të transmetimit dhe tarifës përfundimtare të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018 rezulton një diferencë prej 3 lekë/m³.

- Neni 24, pika 4 e “Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, parashikon se, në çdo rast të paraqitjes së kërkesave për shprehje mendimi nga ana e ERE-s për interpretime të akteve nënligjore të ERE-s, ky mendim do të jetë rezultat i diskutimit dhe qëndrimit të mbajtur në mbledhjen e Bordit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018”, të Bordit të ERE-s ishte “Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh” dhe bëhet “Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh, duke filluar nga data 1.1.2018”.

2. Shoqëria të bëjë korrigjimin e faturave për periudhën 1.1.2018–30.3.2018.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit

të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti